



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVA

GJS-2021-012
Dt. 05.11.2021

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Enver Peci, bazuar në nenin 4 dhe nenin 9 paragrafi 1.2 dhe 6 të Ligjit nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores nr. 05/2019 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 05.11.2021, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa disiplinore e palëve B.K., A.K., I. K., dhe M.K., nga Komuna e D., ushtruar kundër R.R. dhe F.R., gjyqtarë në Gjykatën Supreme.

A r s y e t i m i

Si Autoritet Kompetent, në bazë të nenit 9, paragrafi 5 i Ligjit Nr.06/L-057, Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Ju njoftoj se me datë 07.10.2021, përmes U.d. Kryetarit të Gjykatës së Apelit, z. Afrim Shala, kemi pranuar një ankesë nga palët B.K, A.K., I.K., dhe M.K., nga Komuna e D., me pretendime se me vendimet e ndryshme të gjykatave të Kosovës iu janë shkel të drejtat dhe me këtë rast ka prezantuar edhe vendimet e ndryshme gjyqësore të Gjykatës Themelore në Pejë dega në Deçan si dhe të gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë. Meqenëse pjesë e vendimeve ishin edhe gjyqtarët e kësaj gjykate, R. R., dhe F.R., si autoritet kompetent, shqyrtova pretendimet në ankesë dhe konstatova si vijon:

Ankuesit pretendojnë se: fillimisht Gjykata Themelore në Pejë, dega Deçan, me aktgjykimin C.nr.47/12, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve kundër të paditurve në këtë rast ankuesve B.A.,I., dhe M.K. si të bazuar dhe ka vërtetuar se kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmerisë VR.... dt.26.03. 2012 e lidhur mes M. dhe R.V., si shitës në një anë dhe A.K., si blerës është nulë. Pretendojnë se Gjykata e Apelit në mënyrë të njëanshme me aktvendimin AC.nr. 353/2017, duke aprovuar ankesën e të paditurit e ka prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në vazhdim të pretendimit shprehin pakënaqësi se Gjykata e Apelit në rastin

tjetër penal ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, dega Deçan e gjithashtu shprehin pakënaqësi lidhur me një vendim rreth masës së sigurisë të Gjykatës së Apelit.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesit e ankesës, dhe shkresave të lëndës dhe vendimeve të kontestuar, sa i përket gjyqtarëve të apostrofuara të kësaj gjykate, konstatova se:

Gjyqtari R.R., ka qenë në kolegjin e Gjykatës së Apelit në lëndën penale PA11 820/15, si anëtar i kolegjit dhe në këtë rast është refuzuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë dega Deçan është vërtetuar. Vepra penale ka qenë uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme në këtë rast konkret, konstatoj se ankesa kryesisht ka të bëjë me vendimmarrje të gjyqtarit.

Po ashtu gjyqtari F.R., ka qenë në kolegjin e Gjykatës së Apelit në çështjen juridike të paditësve –propozuesve të sigurimit, tani ankuesve, si anëtar i kolegjit dhe në këtë rast është refuzuar si e pabazuar ankesa e të autorizuarit, të paditurit të tretë A.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, dega Deçan është vërtetuar. Edhe në këtë rast konkret, konstatoj se ankesa kryesisht ka të bëjë me vendimmarrje të gjyqtarit.

Sipas vlerësimit tim, palët ankuese pakënaqësinë lidhur me vendimet në të cilat janë përfshirë gjyqtarët e apostrofuara të kësaj gjykate, i kanë marrë si referenca për vendimin e Gjykatës së Apelit të cekur më lart, me të cilin është prish aktgjykimi i shkallës së parë dhe çështje është kthyer në rivendosje. Bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet se: *“Gjyqtarët gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe veprimet tjera që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre si gjyqtar”*, në rastin konkret konsideroj se veprimet e gjyqtarëve në raport me lëndët konkrete nuk përbëjnë bazë për dyshim për ndonjë sjellje të mundshme disiplinore. Kësisoj, konstatohet se vendimmarrja është bazuar nga gjykatat në tri baza të ndryshme, kontestimore, penale dhe masa sigurie dhe nuk është në autoritetin kompetent, në këtë rast Kryetarit të Gjykatës Supreme të vlerësoj ligjshmërinë e këtyre vendimeve gjyqësore, rastet janë në procedura të rregullta gjyqësore dhe vetëm nëse me prova konkrete vërtetohet se gjatë vendimmarrjes ka pas sjellje që bien ndesh me Kodin e Etikës për Gjyqtarë ose Shkelje disiplinore për gjyqtarë sipas Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, atëherë është në kompetencën time të veproj.

Andaj, për shkak se në parashtrësën e palës, nuk potencohet për ndonjë shkelje konkrete të supozuar disiplinore të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kryetar i Gjykatës Supreme

Enver Peci

Kopje:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
2. Gjyqtarëve R.R., dhe F.R.
3. Arkivit të Gjykatës Supreme
4. Palëve ankuese